

DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK NË SKENDERAJ

Data : 17, Dhjetor , 2025



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2026

No. 14-112/01-0005361/25

Data.

Data. 22. 12. 2025

1. QËLLIMI I PLANIT

Ky Plan Vjetor i Prokurimit është përgatitur në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe rregulloret përkatëse, me qëllim të planifikimit transparent, efikas dhe ekonomik të të gjitha aktiviteteve të prokurimit për vitin 2026.

Plani i punës i Drejtorisë së prokurimit në përgjithësi duhet të jetë i harmonizuar dhe do të korrespondoj me kufijtë të buxhetit të Autoritetit Kontraktues për vitin 2026, për të gjitha shtyllat e buxhetit, andaj Drejtoria e Prokurimit, në kuadër të autorizimeve ligjore dhe përgjegjesive të saj për vitin 2026 me autorizimin e ZKA-së do të procedojë në zhvillimin e procedurave për lidhjen e kontaktave publike për kategorie mallra dhe shërbime të cilat skadojnë përgjat vitit fiskal si dhe ato të projekteve të reja kapitale të cilat janë paraparë në kuadër të buxhetit për vitin 2026 (përfshirë ndryshimeve të projekteve me rishikim të buxhetit dhe përcjellja e procedurave që rrjedhin nga viti paraparak).

Drejtoria e Prokurimit gjatë vitit 2026 planifikon t'i kryej këto në kuadër të Njësive kërkuese të komunës së Skenderajt dhe në kuadër të Drejtorisë si vijon:

1. Përgatitja e buxhetit për vitin 2026 (korniza afatmeseme buxhetore, rrjedha e parasë , përcjellja e buxhetit dhe shfrytëzimi i tij në mënyrë transparente), Përgatitja e planit të prokurimit, preliminar , përfundimtar.
2. Përgatitja e raporteve të punës (muajore, vjetore).
3. Në bashkëpunim me Njësitë kërkuese dhe ZKA (Kryetarin e Komunës) do të hartohet Plani përfundimtar i prokurimeve për vitin 2026 dhe sipas LPP-së dhe [Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik](#) dhe do të dorëzohet në AQP.
4. Do ta finalizojmë Raportin përfundimtar për kontratat e nënshkuara dhe do ta dorëzojmë në KRPP (Janar 2026).
5. Në muajin Janar / 2026 do të kryhen të gjitha procedurat për interes të Njësive kërkuese, përfshirë furnizime , shërbime , punë (kapitale), konkurse projektimi dhe procedurat tjera (të cilat janë emergjente apo të ngajshme) të përfshira në Planifikimin përfundimtar të Prokurimit (AQP).
6. Nga muaji Janar / 2026 do të insistohet që të fillohet me zhvillimin e procedurave, caktohen anëtarët e komisioneve në vlerësim do të ipen propozimet për anëtar të komisioneve, menaxher / mbikqyres ndërsa ZKA do të nxjerrë Vendim dhe do ta nënshkruaj duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

7. Do të hartohet një Listë e anëtarëve të komisioneve për hapje të tenderëve, të cilët do të marrin pjesë në hapje të ofertave.
8. Sipas Planit Preliminar të prokurimeve gjatë vitit 2026 do të publikohen të gjitha procedurat e inicuar nga Njësitë kërkuese, për Furnizime, Sherbime dhe Punë (projekte kapitale si projekte).
9. Publikimi i tenderëve do të bëhet konform Planit të prokurimeve si dhe kërkesave që vijnë nga Njësitë kërkuese.
10. Gjatë vitit 2026 Drejtoria e Prokurimit llogaritet që për nevojat e Njësive kërkuese t'i kryej të gjitha procedurat pa Publikimin e Njofimit per Kontratë apo me negociata (aneks kontrata), kuotime çmimesh dhe vlera minimale varësisht prej nevojës.
11. Gjatë vitit 2026 Drejtoria e Prokurimit do të hartoj raporte javore, mujore dhe Tremujore, Raportetet tremujore do të dorëzohen tek Zyra e Kryetarit dhe në KRPP.
12. Gjatë vitit 2026 Drejtoria e Prokurimit do të insistoj që të gjitha kushtet dhe kriteret do të hartohen konform LPP – së dhe në bashkëpunim me Njësitë kërkuese.
13. Gjatë vitit 2026 do të insistohet që kërkesat fillestare, ZP do të pranoj vetëm kërkesa për të cilat do të zhvillohen procedurat e prokurimit të cilat janë të përfshira në Planifikimin përfundimtar të prokurimit dhe punë të tjera që obligon LPP , Rregullorja, Udhëzusi dhe legjislacioni në fuqi.
14. HARMONIZIMI ME BUXHETIN - Të gjitha aktivitetet e planifikuara në këtë plan janë të harmonizuara me linjat buxhetore të miratuara për vitin 2026 dhe në harmoni me planifikimin e prokurimit 2026 dhe nuk tejkalojnë kufijtë financiarë të përcaktuar.
15. Planit do të monitorohet gjatë gjithë vitit 2026. Çdo ndryshim do të bëhet vetëm me arsyetim dhe miratim zyrtar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Drejtoria e Prokurimit publik për vitin 2026 do të jetë e përkushtuar që të rris transparencën dhe llogaridhënjen, zhvillimi i kapaciteteve të personelit, përdorimi efikas i buxhetit, menaxhimi i ankesave dhe qasje transparente për të gjitha palët e interesit dhe ligjeve në fuqi.

Drejtoria e Prokurimit Publik

